

UDHËZIM
Nr. 25, datë 5.10.2015

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008 “PËR TAKSAT
KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Në pikën 2.3, pas paragrafit të dhjetë, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në rastet e tjetërsimit të mjetit, zyrat noteriale përpara se të kryejnë procedurat e nevojshme ligjore për shitjen e tij, i kërkojnë shitësit të mjetit vërtetim nga DPSHTRR-ja nëpërmjet drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor që mjeti nuk është debitor i taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit apo nuk është i bllokuar nga organet kompetente të përcaktuara me ligj”.

Drejtoritë rajonale tatimore që të lëshojnë vërtetim “Për shlyerjen e detyrimeve tatimore” për çdo tatimpagues duhet të kërkojnë më parë vërtetim nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor për shlyerjen e “Taksës vjetore të mjeteve të përdorura”, të mjeteve në pronësi të tatimpaguesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani